



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

---

Numri i lëndës: 2020:084742

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06524424

**C.nr.204/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin e çështjes Jashar Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: M. S., K. S., K. S. dhe K. S., që të gjithë me vendbanim nga Prishtina, të cilët i përfaqëson i autorizuari Xhafer Maloku, avokat në Klinë, kundër të paditurës: Komuna e Klinës, me bazë juridike: vërtetim pronësie, vlera e kontestit: 3,500.00€, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 14.10.2024, ku prezent ishin paditësja M. S., i autorizuari i paditësve Av. Xhafer Maloku, dhe përfaqësuesi i të paditurës D. R., ndërsa me datë 18.11.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. REFUZOHET, si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve M. S., K. S., K. S. dhe K. S., që të gjithë me vendbanim nga Prishtina, me të cilën kanë kërkuar si vijon: VËRTETOHET, se paditësi Dr. Sh. S., ka të drejtën e banimit në banesën nr. 9 që ndodhet në Klinë, tani në rrugën "Dëshmorët e Kombit" P+4/I, në sipërfaqe prej 39 m<sup>2</sup>, me çka e paditura DETYROHET, t'ia pranoj këtë të drejtë nën kërcenim të ekzekutimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi Sh. S., përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi përmes të autorizuarit të tij me datë 01.11.2002, kundër të paditurës Shtëpia e Shëndetit në Klinë, me bazë juridike: vërtetim i të drejtës banesore. Ku fillimisht ka theksuar se paditësi më parë ishte punëtor

në marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar tek e paditura. Nga kjo bazë ai edhe e kishte marrë nga e paditura banesën njëdhomëshe në shfrytëzim të përhershme e që ndodhej në Klinë, në rrugën ‘‘Ramiz Sadiku’’, P+4/I, banesa nr. 9, në sipërfaqe prej 39 m<sup>2</sup>. Për këtë paditësi me datën 01.06.1979, madje me ish BVI për banim kishte lidhur edhe kontratë dhe ajo te BVI ishte e regjistruar nën numrin rendor 131. Tani kjo kontratë nuk ndodhet për shkak të shkatërrimit të dokumentacionit, nga baza e kësaj kontrate, paditësi kishte paguar edhe obligimet siç është qiraja, rryma, telefonit etj. Në ndërkohë paditësi arrestohet nga policia dhe për veprimtari siç quhej të irredentizmit dhe të nacionalizmit shqiptarë në vitin 1991 dhe dënohet me dënim me burg 1.5 vite dhe derisa ishte në vuajtje të dënimit e paditura ia ndërprente marrëdhënien e punës. Dhe për shkak se paditësi ishte në burg familja e tij detyrohet të vendoset të jetoj me familjen e bashkëshortes së paditësit, pasi që nga papunësia, nuk mund të jetonin në Klinë, ndonëse kohë pas kohe edhe jetonin në Klinë për të mos e shkëputur kontinuitetin e banimit. Mirëpo pavarësisht nga kjo, e paditura banesën lëndore ia jep në mënyrë të kundërligjshme një punëtori tjetër serb B. B., i cili pastaj këtë ia shet një personi tjetër po ashtu serb, ndonëse kontrata mbi shfrytëzimin e banesës së paditësit ende ishte në fuqi madje është edhe sot. Në ndërkohë lidhur me anulimin e kontratës për shfrytëzimin nuk zhvillohej ndonjë kontest gjyqësor, tani në këtë banesë është i vendosur përkohësisht një person tjetër.

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë, me aktgjykimin me shenjen C.nr. 276/2002, të datës 21.02.2015, kishte refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktvendimin CA.nr.1080/2015, të datës 24.04.2015 kishte aprovuar si të themeltë ankesën e paditësit, duke e prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë C.nr. 276/2002, i datës 21.02.2015, dhe duke e kthyer çështjen në rigjykim në Gjykatën e shkallës së parë, e për më shumë sikurse në arsyetimin e këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë, me aktgjykimin me shenjen C.nr. 126/15, të datës 06.05.2015, kishte refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktvendimin CA.nr.3300/2016, të datës 15.06.2020, kishte aprovuar si të themeltë ankesën e paditësit, duke e prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë C.nr. 126/2015, i datës 06.05.2015, dhe duke e kthyer çështjen në rigjykim në Gjykatën e shkallës së parë, e për më shumë sikurse në arsyetimin e këtij aktvendimi.

I autorizuari i paditësit me datë 21.02.2024, në këtë gjykatë ka parashtruar parashtrësë për precizim subjektiv të padisë, me të cilën ka konstatuar se paditësi Dr.Sh. S., ka vdekur me datë 16.12.2023, dhe ka lënë pas vetës trashëgimtarët e radhës së parë të trashëgimisë M. S.-Bashkëshorte, K. S., K. S. dhe K. S.-fëmijët, të cilët tani e tutje emërtohen si paditës.

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbeten në tërësi pranë thënieve nga padia, atyre të paraqitura në parashtrësat e dorëzuara në formë të shkruar në gjykatë si dhe të gjitha parashtrimeve gojore të shprehura në seancat e kaluara lidhur me këtë çështje juridike. Në bazë të librit të protokollit të ish BVI për banim në Klinë, është vërtetuar se paraardhësi juridik i paditësve, tanimë i ndjerë Dr. Sh. S., me datën 01.06.1979, ka lidhë kontratë për shfrytëzimin e banesës me këtë BVI, e cila ndodhet në Klinë, atëherë rruga Ramiz Sadiku, tani Dëshmorët e Kombit, në objektin P+4, hyrja I, kati i 3-të, banesa nr. 7, në sipërfaqe prej 39.99 m2 dhe e njëjta në këtë protokoll është regjistruar në numrin rendor 131, gjë që është në pajtim me dispozitën e nenit 2.1 të Ligjit për marrëdhëniet banesore (Gazeta Zyrtare e KSA e Kosovës ‘NR. 11/83, 29/86 dhe 42/86), sipas të cilës: qytetari i cili është i vendosur në banesën e pronësisë shoqërore në bazë të kontratës mbi shfrytëzimin e banesës, fiton të drejtën që këtë banesë ta shfrytëzojë përherë për plotësimin e nevojave personale dhe familjare në kushtet e caktuara me këtë ligj dhe në pajtim me ligjin e veçantë të marrë pjesë në qeverisjen e ndërtesave të banimit ( e drejta banesore), si dhe nenit 37 të të njëjtit ligj, sipas të cilit: kontrata mbi shfrytëzimin e banesës lidhet në mes të personit i cili ka marrë banesën për shfrytëzim dhe Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit për banim ( në tekstin e mëtejme: bashkësia), në bazë të aktit të dhënësit të banesës në shfrytëzim. Kontrata mbi shfrytëzimin e banesës lidhet në formë të shkruar, pastaj në bazë të kartelës të kontabilitetit numër 144, është vërtetuar se titullari i të drejtës së shfrytëzimit të përhershëm të banesës, Dr. Sh. S., ka paguar qeran mujorepër banesë që nga fillimi deri në fund të vitit 1980, në ndërkohë që në bazë të kartelave të vaksinimit për fëmijët, e tij është vërtetuar se të gjithë fëmijët e Sh. S., banues në banesën lëndore, kanë marrë rregullisht vaksinat vjetore përfundimisht me 30.12.1986. Ndërkaq gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se paraardhësit juridik të paditësve ju është mohuar kontrata për shfrytëzimin e banesës në pajtim me dispozitat e neneve 45-55 të Ligjit mbi marrëdhënien banesore, dhe as kjo kontratë është shuar apo pezulluar më ndonjëherë nga dispozitat e nenit 56-58 të të njëjtit ligj. Andaj i njëjti i ka propozuar gjykatës që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia dhe paditësve të ju njihet e drejta e shfrytëzimit të përhershme në banesën lëndore. Shpenzime e procedurës gjyqësore i ka kërkuar si në parashtrësën e dt.21.10.2024.

Përfaqësuesi i të paditurës, në përgjigjen në padi, gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e kundërshtojnë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar në ligj, të paargumentuara me prova dhe të parashkruar jashtë çdo afati të mundshëm ligjor. Që nga fillimi paditësit dhe i autorizuari i tyre kishin dështuar gjatë tërë procedurës duke mos e bazuar padinë dhe kërkesëpadinë në asnjë provë valide ashtu edhe siç e kërkonte ligji i asaj kohe (LMB-Ligji për Marrëdhëniet Banesore neni 32) respektivisht vendimin valid për shfrytëzimin e banesës kontestuese. Paditësit asnjëherë gjer me tani nuk ishin në gjendje të paraqesin Kontratën valide mbi të drejtën e shfrytëzimit siç e kërkonte neni 37 dhe 38 i LMB-së, e lere me të pronësisë ashtu siç kishte kërkuar me anë të precizimit të kërkesëpadisë së dt. 21.02.2024. Fakt relevant në rastin konkret ishte se paditësit i kishin munguar dy provat kryesore valide që i ka njohur edhe ligji i asaj kohe e që ishin Vendimi i ndarjes së shfrytëzimit të banesës dhe Kontrata e shfrytëzimit që realisht e përcaktonte të drejtat dhe detyrimet e palëve, andaj çdo vendosje e gjykatës së faktit jashtë kësaj gjendje ligjore dhe faktike përben vendim jo të drejtë dhe të pabazuar në ligj dhe prova. Po ashtu me relevancë të theksohet se banesa lëndore si shfrytëzues i fundit e ka privatizuar Z. M. R. në vitin 1994, me Kontratën valide të privatizimit e cila kontratë ishte deponuar gjykatës së faktit dhe e cila kontratë mban Leg. nr. 485/94, të dt. 24.08.1994, madje kjo banesë më vonë është shitur në procedurë të rregullt personit N. K., nga Klina, siç shihet nga kontrata e shitblerjes së dt. 31.03.2010 dhe vërtetimi i saj nga Gjykata Komunale Klinë, Ver. 631/2020, provë kjo e deponuar po ashtu me kohë gjykatës së faktit në Klinë, prova këto të paraqitura në shqyrtimin e dt. 16.01.2015. prandaj duke pasur parasysh këto se banesa lëndore ishte pjesë e transaksioneve të shitblerjes dhe kontratave të vërtetuara nga vet Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, përben një fakt shumë të rëndësishëm se këtu paditësit realisht nuk kanë kurrfarë të drejte në banesën kontestuese as të drejtën e shfrytëzimit e as të pronësisë. Po ashtu në rastin konkret me kohë kemi sqaruar se në këtë çështje kontestimore ishte prezent edhe parashkrimi ngase qysh në kohën pretenduese të banimit nga pala paditëse vitin 1979 e deri në parashtrimin e padisë në Gjykatë kemi kalim të më shumë se 20 vite vonesë e që nënkupton humbjen definitive të vet drejtës pretenduese ngase një e drejtë e tillë ishte lidhur me afat ligjor strikt dhe pasoja për palët përgjegjëse. Andaj duke u bazuar në këtë gjendje faktike dhe juridike si dhe fakteve vendimtare, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kundër argumenteve dhe të gjitha provave i propozojnë gjykatës që të refuzojë padinë dhe kërkesën kontestuese të paditësve si të pabazuar me ligj dhe prova por edhe si të pasafatshme. Shpenzimet e procedurës nuk i kanë kërkuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes së plotë faktike dhe me propozimin e palëve ndërgjyqëse zhvilloi procedurën e provave dhe administroj këto prova si në vijim: kontrata mbi

blerjen e banesës (privatizimit) nr. 11/88 të dt. 31.04.1993, leg. nr. 485/94, e dt. 23.09.1994 e vërtetuar dhe e legalizuar nga Gjykata Komunale në Klinë, kontrata për shitblerjen e patundshmërisë lëndore vërtetuar në Gjykatën Komunale në Klinë, me numër të legalizimit nr. 631/2010, datës 31.03.2020, njoftimi numër 32/13, të datës 23.10.2010, lëshuar nga arkivi publik i Klinës, ekstrakti i evidencës së shfrytëzuesve të banesës i vërtetuar nga R. R., kartela për vakacionimin e fëmijëve të paditësit K. S., K. S., K. S., certifikata nga Libri i të lindurve në emër të K. S., nr. 200/1260, të dt. 23.09.1994, lista mbi shitblerjen e banesës me hipotekë libri nr. 3 me numër rendor 120 i dt. 24. 08. 1994, deklarata e dëshmitarit Dr. A. A., deklarata e dëshmitarit Xh. Rr., Deklarata e dëshmitarit H. G., R. Rr., deklarata e dëshmitarit Dr. H. I., deklarata e dëshmitarit B. G. dhe deklarata e dëshmitarit T. B., ekspertiza e gjeodezisë e nxjerrë nga eksperti G. K., e dt. 11.07.2024.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç e në lidhmëni njëra me tjetrën, çmuarjes me kujdes dhe ndërgjegje e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga kontrata mbi blerjen e banesës (privatizimit) nr. 11/88 të dt. 31.04.1993, leg. nr. 485/94, e dt. 23.09.1994 e vërtetuar dhe e legalizuar nga Gjykata Komunale në Klinë, gjykata gjeti kjo kontratë është lidhur mes Qendrës Mjekësore në Pejë-Shtëpia e Shëndetit Klinë si shitës, ndërsa blerësi R. M., nga Klina, objekt i kontratës banesa me sipërfaqe 39.99m<sup>2</sup>.

Nga kontrata për shitblerjen e patundshmërisë lëndore vërtetuar në Gjykatën Komunale në Klinë, me numër të legalizimit nr. 631/2010, datës 31.03.2020, gjykata gjeti se kjo kontratë është lidhur mes M. V. R.-si shitës, ndërsa N. I. K. si blerës, me objekt banesa e blerë nga Qendra Shëndetësore –Pejë, Shtëpia e Shëndetit në Klinë, me sipërfaqe prej 39.99m<sup>2</sup>.

Nga njoftimi numër 32/13, të datës 23.10.2010, gjykata gjeti se në bazë të kërkesës së Xhafer Maloku, avokat nga Klina, e dt. 19.08.2013, i cili ka kërkuar dokumentacionin për M. R., nga Klina, lidhur me çështjet banesore, e njëjta lëndë nuk është gjetur në evidencat e Arkivit Historik të Klinës, për shkak se lënda nuk ka hyrë në arkiv.

Nga lista mbi shitblerjen e banesës me hipotekë libri nr. 3 me numër rendor 120 i dt. 24. 08. 1994, gjykata gjeti se: banesa me sipërfaqe prej 39.99m<sup>2</sup> e blerë në bazë të kontratës dhe e paguar në tërësi nga R. M., e cila gjendet Rr. ‘ Ramiz Sadiku’, pa numër.

Në ekspertizën e gjeodezisë e dt. 11.07.2024, e punuar nga G. K.- ekspert i gjeodezisë, nuk është konstatuar, pasi që i njëjti nuk ka mundur të siguroj informacione për banesën e cila është kontesuese.

Dëshmitari R. R., në shqyrtimin gjyqësor të dt. 18.09.2009, ka deklaruar se: në vitin 1979, ka qenë duke punuar në BVI, për banim në Klinë, në pozitën e udhëheqësit të kontabilitetit. Në momentin kur i është ndarë banesa një personit ka qenë i obliguar që të lidhin kontratë mbi qiran me BVI, për banim, të gjitha kontratat të cilat kanë qenë të lidhura me banues kanë qenë të protokolluara dhe të nënshkruara nga sekretari i BVI dhe nga shfrytëzuesi i banesës. I njëjti ka deklaruar se ka bërë hyrje daljen e fakturave të cilat në atë kohë kanë qenë kompetent, fakturimin për qira dhe asgjë tjetër. Çdo shfrytëzues ka pasur kartelën financiare. I njëjti deklaroi se ka njohuri qe Dr. Sh. S. ka punuar në Shtëpinë e Shendetit, dhe se ka pasur banesë në Klinë, mirëpo rruga nuk i kujtohet, nuk i kujtohet se ka qenë në banesën e Sh. S., mirëpo i njëjti deklaroi se nuk e ka paguar qiran në mënyrë të rregullt por pjeserisht, i njëjti deklaroi se nuk i kujtohet se a ka pasur kontratë mbi shfrytëzimin e banesës, mirëpo një kopje të kontratave kanë mbetë tek BVI për banim dhe një kopje palës dhe një kopje tjetër Drejtorisë për Urbanizëm të asaj kohe.

Dëshmitari A. A., nga Klina, në shqyrtimin gjyqësor të dt. 17.06.2013, ka deklaruar se: nuk ka njohuri nga viti 1999, që paditësi të ketë parashtruar ndonjë parashtrësë për rikthimin e të drejtës së banesës apo rikthimin e saj. E njëjta deklaroi se pas luftës nuk kanë asnjë fond banesor për ndarjen apo kompesnimin e banesave, dhe pas viteve të 90-ta me sa ka njohuri nuk ka mbetur ndonjë banesë që ka qenë në shfrytëzim e paprivatizuar, mirëpo për këtë nuk merr përgjegjësi të plotë ndoshta ka mundur të mbetet ndonjë që ka pasur pengesë ligjore për të cilat nuk ka njohuri. i njëjti deklaroi se e ka njohur mirë Dr. Sh. S., mirëpo ai ka filluar në vitin 1978 ndërsa unë ka filluar në vitin 1982, i kujtohet se ka pasur banesë por se nga kush i është ndarë nuk e di, vetëm si kam ndëgjuar banesa në fjal i është ndarë një serbi. I njëjti ka deklaruar se kur jam ftuar nga kjo gjykatë, e kam thirrur sekretariatën pasi që tani jam drejtor dhe i kam thënë të hulumtoj rreth dokumentacionit, mirëpo nuk kemi gjetur asgjë a mungon dokumentacioni për këtë banesë apo edhe për të tjerat nuk e di.

Dëshmitari Xh. R., nga Klina, në shqyrtimin gjyqësor të dt. 17.06.2013, ka deklaruar se: punën në Shtëpinë e Shendetit e ka filluar në vitin 2003 dhe me parë, se çka ka ndodhur nuk e di, mirëpo i njëjti deklaroi pasi që kam pozitën e sekretarit me urdhër të drejtorit ka hulumtuar arkivën dhe dosjet, mirëpo nuk ka mundur të gjej dokumentacionin rreth atyre. I njëjti deklaroi se nuk ka njohuri se a janë privatizuar të gjitha banesat që kanë qenë në shfrytëzim dhe as që ka pasur ndonjë kërkesë tjerë së paku nga 2003-ta, që kur ka filluar punën. Gjithashtu deklaroi se Sh. S. e ka njohur qytetar të klinës dhe si mjekë pasi që edhe janë vizituar, mirëpo se a ka pasur një banesë dhe ku ka banuar nuk e di pasi që i njëjti me punë në atë kohë ka qenë në Volljak.

Dëshmitari H. G. nga Peja, në shqyrtimin gjyqësor të dt. 16.07.2013, ka deklaruar se: me shumë se 30 vite ka punuar në BVI, për banim prej prej 1976 e deri me 1982, ka qenë shef i kontabilitetit, i njëjti ka deklaruar se Dr. Sh. S., nuk e njeh. Kur është formuar BVI-ja nuk ka pasur kurrfarë dokumentacioni, mirëpo ka ekzistuar komisioni prej 3 antarësh për të formuar aktivën dhe pasivën për banim, me synim edhe evidentimin e banesave, me kontrata të banesave, shtëpi për shtëpi me kontrata të evidentuara familjet dhe antarët që banojnë në ato banesa në atë kohë. Objekti lëndor i cili është në kontest është i ndërtuar nga fondi i mjetve të BVI-së për banim, dhe asnjë banues nuk ka mundur të banoj pa e nënshkruar kontratën për shfrytëzimin e banesës. I njëjti deklaroi se e ka njohur M. B. pasi që ka punuar në Shtëpinë e Shendetit.

Dëshmitari H. I., nga Klina, në shqyrtimin gjyqësor të dt. 22.10.2013, ka deklaruar se: se në vitin 1990 ka filluar punën në Shtëpinë e Shendetit, në kohën kur ka qenë drejtor që nga 1999 e deri në 2002, nuk ka gjetur asnjë dokumentacion se Shtëpia e Shendetit ka trashëguar fonde banesore, dhe sa ka informat pas luftës nuk ka pasur banesa, i njëjti deklaroi se i kujtohet personi me emrin R. M. pasi ka punuar si teknik medicinal në repartin e stomatologjisë, gjithashtu ka deklaruar se e ka njohur edhe Sh. S., dhe se i njëjti ka pasur banesë, pasi që me të kemi pasur edhe raporte familjare, ku çdo të tretën ditë ai ka qenë te ne, mirëpo nuk më kujtohet vendi se ku ka e ka pasur, pasi që dy banesa kanë qenë në atë kohë por në cilën e ka pasur se di, por e di që ka qenë në të djathën, kanë qenë në rrugën për në Skenderaj, rruga ka qenë Ramiz Sadiku dhe tani është Dëshmorët e Kombit.

Dëshmitari B. G., nga Klina, në shqyrtimin gjyqësor të dt. 22.10.2013, ka deklaruar se: e njeh Dr. Sh. S. dhe familjen e tij, në vitin 1978, i është ndarë banesa, dhe në atë kohë banesar janë ndarë në proporcion 2 me një në çdo kat, dy shqiptar dhe një serb dhe si fqinjë i ka pasur M. B. dhe Sh. S., i njëjti deklaroi se Sh. S. ka jetuar në të njëjten banesë dhe i kanë lindur dy fëmijët,

nuk me kujtohet se deri kur ka jetuar, mirëpo një kohë Sh. S. e kanë dërguar që të punojë si mjek në fshatin Kijevë. Po ashtu i njëjti deklaroi se pas Sh. S. e kanë sjellur R. M., i cili është vendosur dhunshëm deri në përfundimin e luftës së fundit në Kosovë. Banesa gjendet në anën e djathtë të rrugës Klinë-Skenderaj.

Dëshmitari T. B., nga Klina, në shqyrtimin gjyqësor të dt. 27.01.2014, ka deklaruar se: punën si teknik i stomatologjisë në QKMF në Klinë, që nga viti 1974, Dr. Sh. S., në atë kohë ka ardhur si kuadër në Shtëpinë e Shëndetit në Klinë, në vitin 1977, i cili ka filluar si mjek i praktikës së përgjithshme, meqë i njëjti ka ardhur nga R. e Maqedonisë, e ka pranuar banesën e cila i është ndarë në 77 apo 78 si kuadër nga Shtëpia e Shëndetit. Para se të vendoset Sh. S., në të ka qenë një mjek tjetër Dr. H. D., i cili ka qenë si kuadër. Dr. Sh. S., ka punuar në Shtëpinë e Shëndetit deri në momentin kur është arrestuar nga pushteti Jugosllav diku ka qenë 80 apo 81, nuk i kujtohet sakt, dhe pas arrestimit ka qenë në vuajtje të dënimit dhe pasi është liruar nuk është kthyer që të punoj më në Shtëpinë e Shëndetit. Banesa në të cilën ka banuar në atë kohë gjendet në rrugën Klinë- Skenderaj, në anën e djathtë, hyrja e parë, kati i tretë, banesa ka qenë diku rreth 41m<sup>2</sup>. Gjatë periudhës kur Shaqiri ka qenë në burg në atë banesë kanë jetuar gruaja e tij me fëmijët, ndërkaq pas përfundimit të burgut në atë banesë më nuk kanë jetuar por pastaj ka banuar Dr. Sh. L. 1 vit, më pas i është ndarë Dr. B. B., dhe meqë M. R. ka pasur lidhje miqësore me Dr. B., dhe meqenëse unë kam qenë i pa martuar, banesa i është ndarë M. R., i cili ka qenë teknik i stomatologjisë, dhe banesa i është ndarë në vitin 1987, sa i kujtohet në atë kohë Kshilli i punëtorëve të Shtëpisë së Shëndetit, dhe kur kjo banesë i është ndarë M. dhe i është lëshuar vendimi drejtor ka qenë Xh. M.. i njëjti deklaroi se nuk i kujtohet se Sh. S. është ankuar për banesën në fjalë.

Deklarimit të dëshmitarëve, gjykata u falë besimin, sepse deklaratat e tyre përputheshin me gjendjen faktike, si dhe për faktin se të njëjtit kishin njohuri lidhur me çështjen kontestuese.

Nuk është kontestuese fakti se disa punëtorëve të cilët kanë punuar në Shtëpinë e Shëndetit në Klinë, iu është dhënë në shfrytëzim banesë për banim së bashku me familje.

Kontestuese në këtë çështje juridike kontestimore është se paditësve a ju takon e drejta e shfrytëzimit të përhershme në banesën e cila është objekt në këtë çështje juridike kontestimore.



Gjykata me rastin e vendosjes, duke i analizuar provat që gjenden në shkresat e lëndës ka ardhur në përfundim se duhet vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 7 par. 1, të LPK-së, i cili përcakton se: *‘palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla’*, më pas në bazë të nenit 319 par. 1,2 dhe 3 të po këtij ligji është përcaktuar se: *‘Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta’*, *‘Të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit’*, *‘Gjykata vendosë se cilat prova do të merren me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare’*, kurse në nenin 322 par 1, 2, të po këtij ligji përcakton se: *‘Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës’*, *‘Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër’*. Prandaj duke ju referuar një gjendje të tillë faktike, si dhe dispozitave imperativë të aplikueshme rrjedhë se nuk është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë dhe si e tillë gjykata e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, e veçmas kur merret parasysh se paditësit, gjykatës nuk kanë mundur që ti prezantojnë dëshmi dhe fakte me të cilat vërtetohet e drejta e shfrytëzimit të përhershme në banesën e cila është objekt i kësaj çështje juridike kontestimore, edhe pas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, me të cilat dëshmi dhe fakte e mbështesin kërkesën e tyre. Gjykata, po ashtu thekson faktin se paditësit në shqyrtimin e çështjes duhet të kenë rolin më pro aktiv në vërtetimin e gjendjes faktike duke ofruar prova apo duke i shfrytëzuar provat ekzistuese për të bërë të bazuar kërkesëpadinë e tyre.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera të përfaqësuesit të palës paditëse dhe të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për arsye se me provat e administruara dhe shkresat e lëndës është argumentuar e kundërta, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj në mungesë të provave sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë dhe lartësisë së saj, gjykata refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve konform nenit 7, 319 dhe 322 të LPK.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në dispozitivin II, të këtij aktgjykimi, ashtu që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 449, 450 të LPK-së,

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË**

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.204/20, datë 18.11.2024.

Gjyqtari

Jashar Gashi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate.